Kandidati Frashër Brahimaj, ka kryer studimet e doktoratës në universitetin Goce Delcev ne Shtip të Maqedonisë së Veriut, si dhe ka marrë pjesë në Shkollën Minerare ESEE në Dubrovnik të Kroacisë në vitin 2018 dhe 2019, në kohëzgjatje totale rreth 10 ditë për të cilën janë ofruar certifikata pjesëmarrje në aplikacion.

5. Vlerësimi i kandidatit/es në intervistë (në rastet e krijimit të marrëdhënies së punës për herë të parë)

(Në këtë pjesë të raportit, komisioni duhet të ofrojë të dhëna të sakta dhe të plota, sipas pikës 2 të nenit 167 të Statutit të UIBM dhe pikave 2,3,4 të nenit 11 Rregullore me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024).

Kandidatit i janë bërë disa pyetje nga komisioni në të cila është përgjigjur me vetbesim. Vlen të veçohet pyetja e lidhshmërisë së lëndëve në konkurs me përvojën e tij, kryesisht nga sipërfaqësorja dhe lëndët që lidhen me minierat sipërfaqësore në të cilën kandidati thotë se nuk e ka problem ndryshimin në nëntokësore sepse shpim plasja si orientim i tij kryesor profesional, përdoret edhe në minierën nëntokësore.

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Raporti i Komisionit vlerësues për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik sipas konkursit të datës 09.09.2024

Shënimet për kandidatin/en për të cilin/en shkruhet raporti

Kandidati/ja 2

Emri dhe mbiemri	<i>Gzim Ibishi</i>
Datëlindja dhe vendlindja	<i>08.10.1988, Mitrovicë</i>
Grada shkencore	<i>PhD në inxhinieri minerare</i>
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje, avancim)	<i>Profesor Asistent</i>
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje, avancim)	<i>2020</i>
Universiteti/Fakulteti/Departamenti	<i>Universiteti Isa Boletini Mitrovicë Fakulteti i Gjeoshkencave Departamenti i Xehetarisë</i>
Arsimimi i lartë	
Studimet e doktoratës-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i doktorimit, (nostrifikimi nëse kandidati/ja ka studiuar jashtë vendit)	<i>Universiteti Osmangazi në Eskisehir, Turqi. Instituti i Shkencave dhe Teknologjisë Departamenti i Inxhinierisë së Minerave Dokoratë në Inxhinierinë e Minerave, 2019. Nostrifikimi: 12.06.2019</i>
Studimet Master/Magjistraturë, Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare (nostrifikimi nëse kandidati/ja ka studiuar jashtë vendit)	<i>Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë Departamenti i Xehetarisë Master i Shkencave Teknike, 2014. Nota mesatare: 9.35</i>
Studimet themelore-Universiteti, Fakulteti, Departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare (nostrifikimi nëse kandidati/ja ka studiuar jashtë vendit)	<i>Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë Departamenti i Xehetarisë Bachelori i Xehetarisë, 2011. Nota mesatare: 9.00</i>

Sqarim: Në këtë tabelë paraqiten shënimet për secilin kandidat që i shkruhet raporti. Të shtohen tabela, varësisht nga numri i kandidatëve. Për pozitën profesor, komisioni vlerëson fushën e ngushtë nga studimet, Bachelor, Master dhe të Doktoratës (është obligative që të tri nivelet të jenë të fushës përkatëse sipas konkursit), ndërsa për pozitën asistent/e, studimet bachelor dhe master.

2. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit/es

Tabela I: Punimet e publikuara pas thirrjes së fundit në revista, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike, sipas Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024 dhe me Vendimin e Senatit me nr.prot.1757 dt.06.08.2024.

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Platforma	Revista	Impa Faktori	Viti vëllimi, nr., faqet	Linku identifikues ²
1	Kemajl Zeqiri, Stojance Mijalkovski, Gzim Ibishi, Ledi Lavdic Mojsiu	Comprehensive analysis of the mining accident forecasting and risk assessment methodologies: Case study - Stanterg Mine	Scopus	Mining of Mineral Deposits	N/A	2024, 18 (2), 11-17	http://mining.in.ua/2024vol18_2_2.html
2	Gzim Ibishi, Mclih Genis, Mahmut Yavuz	Post-pillars design for safe exploitation at Trepça hard rock mine (Kosovo) based on numerical modeling	Web of Science (WoS)	Geomechanics and Engineering	2.5	2022, 28 (5), 463-475	https://www.tech-press.org/content/?page=article&journal=gae&vol

² Komisioni vlerësues është i obliguar të shënojë linkun nëpërmjet të të cilit dëshmohet indeksimi i punimit përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse

							ume=28&num=5&ordernum=3
3	Kemajl Zeqiri, Muhamedin Hetemi, Ujmir Uka, Gzim Ibishi, Stojance Mijalkovski	Analysis of near-miss incidents (NMI) reporting in mining operations	Scopus	Mining of Mineral Deposits	N/A	2022, 16 (3), 25-30	http://mining.in.ua/2022vol16_3_4.html
4	Kemajl Zeqiri, Gzim Ibishi, Musa Shabani, Joze Kortnik, Mehmet Erding Bilir, Melih Genis, Mahmut Yavuz, Muhamedin Hetemi, Gurkan Bacak	Preliminary support design for underground mine adit, Artana mine, Kosovo	Scopus	Mining Science	N/A	2021, 28, 141-159	http://www.mining-science.pwr.edu.pl/Preliminary-support-design-for-underground-mine-adit-Artana-mine-Kosovo,141444,0,2.html
5	Gzim Ibishi, Mahmut Yavuz, Melih Genis	Underground mining method assessment using decision-making techniques in a fuzzy environment: case study, Trepça mine (Kosovo)	Scopus	Mining of Mineral Deposits	N/A	2020, 14 (3), 134-140	http://mining.in.ua/2020vol14_3_16.html

Sqarim: Autor i parë konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve. Autori korrespondent konsiderohet autori i punimit, i cili shprehimisht është përcaktuar si i tillë në punim. Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se 1 (një) autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë. Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.

Në tabelë duhet të prezantohen punimet pas thirrjes së fundit. Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UIBM -së dhe Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024. Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave për punimet e radhitura në këtë tabelë.

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën I.

(Komisioni vlerësues duhet të ofrojë informata për tipin e publikimeve, për revistën në të cilën ka botuar autori duke iu referuar statusit të kandidatit/es në kuadër të punimit (p.sh. autor i parë etj). "impakt faktorin" e revistës, shtëpinë botuese, ORCID ID etj. Komisioni duhet të precizojë burimin e informatave në të cilin është mbështetur dhe i cili mund të verifikohet. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Kandidati Gzim Ibishi, i ka të publikuar gjithsej 5 punime në revista shkencore të indeksuara në platforma ashtu siç parashihen me Rregulloren për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, **Neni 10**, pika 4.1 dhe 4.2 (WoS dhe SCOPUS).

Tabela I, *punimi nr.1 dhe nr.3* i kandidatit Gzim Ibishi tregon se nuk është as autor i parë dhe as autor korrespondent, por vetëm si bashkautor. Autori ka botuar në revistë, në fushën e Shfrytëzimit të vendburimeve minerale, sipas WoS (<https://mj.lclarivate.com/>) revista bënë pjesë në bërthamën ESCI (*Emergin Sources Citation Index*), nuk posedon impakt faktor, botues është Dnipro University of Technology. Gjithashtu, revista është e indeksuar në platformën SCOPUS nga viti 2016 deri në vitin 2024, të dhënat mund të verifikohen përmes linkut (<https://www.scopus.com/sourceid/21100914192>).

Tabela I, punimi nr.2 i kandidatit Gzim Ibishi tregon se është *autor i parë dhe autor korrespondent*. Autori ka botuar në revistën prestigjioze në fushën e Gjeomekanikes dhe Inxhinierisë sipas WoS (<https://mjl.clarivate.com/>) revista bënë pjesë në bërthamën SCIE (*Science Citation Index Expanded*), dhe posedon impakt faktorin 2.5, shtëpia botuese është TECHNO-PRESS dhe ORCID ID (<https://orcid.org/0000-0002-1160-3881>). Gjithashtu, revista është e indeksuar në platformën SCOPUS nga viti 2009 deri në vitin 2024, të dhënat mund të verifikohen përmes linkut (<https://www.scopus.com/sourceid/19700186912>).

Tabela I, punimi nr.4 i kandidatit Gzim Ibishi tregon se është *autor korrespondent*. Autori ka botuar në revistë, në fushën e Shkencave të Minierave dhe sipas WoS (<https://mjl.clarivate.com/>) revista bënë pjesë në bërthamën ESCI (*Emergin Sources Citation Index*), nuk posedon impakt faktor, botues është Wrocław University of Technology, Faculty of Geoengineering Mining & Geology. Gjithashtu, revista është e indeksuar në platformën SCOPUS nga viti 2014 deri në vitin 2024, të dhënat mund të verifikohen përmes linkut (<https://www.scopus.com/sourceid/211007865310>).

Tabela I, punimi nr.5 i kandidatit Gzim Ibishi tregon se është *autor i parë dhe autor korrespondent*. Autori ka botuar në revistë, në fushën e Shfrytëzimit të vendburimeve të mineraleve, sipas WoS (<https://mjl.clarivate.com/>) revista bënë pjesë në bërthamën ESCI (*Emergin Sources Citation Index*), nuk posedon impakt faktor, botues është Dnipro University of Technology. Gjithashtu, revista është e indeksuar në platformën SCOPUS nga viti 2016 deri në vitin 2024, të dhënat mund të verifikohen përmes linkut (<https://www.scopus.com/sourceid/21100914192>).

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

(Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit/es, universitetet ku ai/ajo ka punuar, programet akademike, kualifikimet, angazhimi në institucione jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura, duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Personelit në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, kuptohet se kandidati Gzim Ibishi, ka themeluar marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin e Gjeoshkencave nga data 01.10.2014 dhe vazhdon tutje. Fillimisht si asistent i rregullt sipas vendimit (nr. prot 03/1090 dt: 03.11.2014), pastaj rizgjedhet asistent sipas vendimit (nr. prot 1390/004 dt: 10.10.2017), dhe së fundi zgjedhet profesor asistent sipas vendimit (nr. prot 1891 dt: 27.11.2020).

Kandidati Gzim Ibishi, angazhimin në institucione jashtë vendit si student i dalluar ka filluar rrugëtimin për herë të parë përmes programit Join-EU SEE/Erasmus Mundus External Cooperation Window mbështetur përmes programit nga Komisioni Europian ka ndjekur studimet për një vit akademik në nivelin Bachelor në Universitetin: Middle East Technical University në Ankara të Turqisë.

Kandidati, në vitin 2014 *(sipas certifikatës së notave)* ka regjistruar studimet e Doktoratës pranë Institutit të Shkencave dhe Teknologjisë/Departamenti i Inxhinierisë së Minierave në Universitetin Osmangazi në Eskisehir/Turqi, ku me datë 17.05.2019 ka përfunduar studimet e Doktoratës dhe ka fituar gradën/titullin Doktor shkence në Inxhinierinë e minierave (nga fusha e ngushtë: Shfrytëzimi nëntokësor), me punimin e doktoratës me titull “*Stability Assessment of Post Pillars in Cut-and-Fill Stopping Method at Trepça Underground Mine*”. Projekti i doktoratës është mbështetur nga Scientific Research Project Supporting Commission of Eskisehir Osmangazi University (*Project no: 201715A238*).

Kandidati, ka të përfunduar edhe studimet e Post-Doktoratës për një periudhë kohore prej 5 muajve (01.05.2022-01.10.2022) në Universitetin: Zonguldak Bulent Ecevit University/Mining Engineering Department, Turqi. Studimet e post-doktoratës i ka të përfunduara në projektin me titull “*Underground rock excavation support design for static and dynamic loading conditions in different rock masses*”, fushë e ngushtë e Gjeomekanikes, punimit të objekteve dhe Tuneleve.

Kandidati Gzim Ibishi, vlerësohet se posedon aftësi pedagogjike dhe atë të mësimdhënies pasi i ka plotësuar të gjitha kërkesat duke i vijuar të gjitha modulet, dhe e ka përfunduar me sukses trajnimin “*Mësimdhënia në arsimin e lartë*” të organizuar dhe realizuar nga Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Kandidati, ka përfunduar me sukses edhe dy trajnim të cilat ndërlidhen drejtëpërsëdrejti me mësimdhënie në arsimin e lartë si ai “*Writing scientific research articles/papers*” dhe “*Integration of Entrepreneurial Competences and Learning Outcomes into Lesson Plans*”, të cilat dëshmohen me Certifikata. Në CV dhe dokumentacionin e kandidatit Gzim Ibishi, shihet se ka referencë akademike dhe rekomandim pozitiv nga dy profesorë të huaj: Prof. Dr. Mahmut Yavuz (Eskisehir Osmangazi University, Turkey) dhe Prof. Dr. Melih Genis (Zonguldak Bulent Ecevit University, Turkey). Nga këto dy referenca akademike, vërehet se kandidati ka fituar njohur në nivelin e avancuar mbi përdorimin dhe aplikimin e softuerëve të kohës, të cilët përdoren nga hapja e objekteve nëntokësore e deri tek Shfrytëzimi nëntokësor. Kandidati Gzim Ibishi, sipas vendimit Nr. Prot. 587 të datë 08.03.2022 është anëtar i Komisionit për hartimin e rregullores për studime të doktoratës.

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Raporti i Komisionit vlerësues për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik sipas konkursit të datës 09.09.2024

Tabela II. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave dhe dispensave,

Nr	Autori/ët	Titulli i publikimit	Shtëpia botuese. vendi. viti	Numri ISBN
1	Gzim Ibishi	<i>Stability assessment of post pillars in cut-and-fill stoping method at Trepça underground mine</i>	Lena Grafik, Prishtinë, 2024	978-9951-29-790-5
2	Nazmi Hasi, Arbër Zeqiraj	<i>Bazat e Gjeofizikës</i>	N/A	Gzim Ibishi, Recenzent
3				

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave të radhitura në tabelën III.

Tabela III. Publikimet nga kongreset dhe konferencat në nivel ndërkombëtar dhe vendor

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Emërtimi i kongresit, konferenca,	Vëllimi, nr., faqet, viti (të dëshmuara me proceedings book, botimi i përmbledhjes së abstrakteve ose agjenda)
1	Kemaj Zeqiri, Gzim Ibishi	Environmental and economic context of the artana mine tailing	15th Conference with international participation of Mining, Gootechnological and Environmental Experts at "48th Jump over the leather skin – GzO'23"	2023
2	Kemaj Zeqiri, Gzim Ibishi	Context of the mining policies to mining legislation framework, Kosovo case	5th International Multidisciplinary Geosciences Conferences - IMGC	2023

Tabela IV. Pjesëmarrja në Komitetet shkencore në kongreset dhe konferencat në nivel ndërkombëtar dhe vendor

Nr	Emërtimi i kongresit, konferencës	Linku /libri i publikimeve
1	IMGC 2024 Kryesues i Konferencës IMGC 2024	www.imgc-2024.net
2	IMGC 2023 Drejtor i Konferencës IMGC 2023	www.imgc-2023.net
3	ICCET 2022 Proceedings of the 22nd International Coal Congress and Exhibition of Turkey	Editor: Dr. Ozgur Yilmaz

Tabela V. Pjesëmarrja në komisionet vlerësuese për zgjedhje dhe avancim të stafit akademik

Nr	Pozitat e konkursit	Pozita në komision	Viti
1	Nuk janë ofruar të dhëna		

Tabela VI. Mentorimi i temave të diplomës

Nr	Emri Mbiemri (i kandidatit/es)	Niveli i studimit	Viti i përfundimit
1	Shpend Azemi (Mentor)	MSc	2024
2	Kushtrim Ahmeti (Mentor)	BSc	2023
3	Arian Shala (Mentor)	BSc	2023
4	Xhemajl Gerguri (anëtar komisioni)	Msc	2021
5	Bujar Jashari (anëtar komisioni)	Msc	2021
6	Përparim Morina (anëtar komisioni)	Msc	2021
7	Avni Preniqi (Kryetar komisioni)	Bsc	2021
8	Aruç Salihu (Kryetar komisioni)	Msc	2023

Sqarim: Plotësohet tabela me emrat e kandidatëve pas thirrjes së fundit.

Tabela VII. Ligjëratat-prezantimet, ligjërues/e i/e fuar në universitet dhe punëtori shkencore nga lëmia e kandidatit/es

Nr	Autorët (renditja si në Ligjëratë/Prezantim)	Titulli i ligjëratës/prezantimit	Lloji i ligjëratës/prezantimit (Universiteti, Punëtori shkencore)	Viti, Vendi
1	M.Hetemi, G. Ibishi	Mineral resources in Kosovo & Brief Overview and Strategic Vision, University of Mitrovica	Zonguldak Bulent Ecevit University, Turkiye	2024, Zonguldak, Turkiye

Tabela VIII. Redaktor/e -Recensent/e në revistat akademike apo shkencore

Nr	Kontributi (redaktore-recensent/e)	Autori/ët e punimit	Titulli i punimit të recensuar	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recension	Vendi, Viti
1	Recenzent	anonim	Investigation of rock fall potential of Zonguldak – Kilimli roadway (Turkey)	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2020
2	Recenzent	anonim	The Joint Response Characteristic of Gas concentration and Temperature in Coal and Gas Outburst Roadway	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2023
3	Recenzent	anonim	Elastic-plastic analysis of normal stress increment and stress paths for bore wall of rock-socketed piles	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2021

4	Recenzent	anonim	Settlement characteristics due to excavate twin tunnels in a supported slope model test and numerical simulation	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2023
5	Recenzent	anonim	Mechanical properties of super-large & shallow-buried bias loess tunnel with small-spacing	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2024
6	Recenzent	anonim	Research on stress change and deformation monitoring of coal pillar between longwall coal faces	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2024
7	Recenzent	anonim	Experimental study of gas concentration and its thermal behaviour in coal and gas outburst	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2021
8	Recenzent	anonim	Study the mechanical performance of excavation under asymmetrical pressure and reinforcement measures	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2021
9	Recenzent	anonim	Investigation of the effects of coal seam slope and top coal drawn height on top coal recovery ratio in longwall top coal caving method applied in steep inclined thick coal seams	Springer nature Arabian Journal of Geosciences www.springer.com	2022

Tabela IX. Trajnimet profesionale

Nr	Trajnimi (Titulli i trajnimit)	Certifikata	Viti
1	HERAS+ “Integration of entrepreneurial competences and Learning Outcomes into lesson plans”	Po	2023
2	Eti Food Co-founded by EU, InfraBooster Foundation	Po	2023
3	Research CULT Co-founded by Erasmus+ Programme of the EU, “Writing scientific research articles/papers”	Po	2023
4	HEXAGON MINING Getting Started with MinePlan 3D Designing, Calculating Reserves and Reporting with Planner Scheduling Mining Cuts with Schedule Optimizer Pit Optimization with MinePlan Project Evaluator	Po	2021

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Raporti i Komisionit vlerësues për emërimin, rrimërimin dhe avancimin e personelit akademik sipas konkursit të datës 09.09.2024

5	UP-Qendra për përsosmëri në mësimdhënie, "Mësimdhënia në arsimin e lartë"	Po	2021
6	Bentley Institute SIG Workshop: Geotechnical Analysis – Working with 3D Deep Excavation in PLAXIS	Po	2020
7	Universiteti Isa Boletini ne Mitrovicë FGJ, ArcGIS: Essentials Workflows	*	2019
7	Zonguldak Bulent Ecevit university Faculty of Engineering/ Mining Engineering Department FLAC3D training	*	2018
8	Eskisehir Osmanagazi University Faculty of Engineering and Architecture/ Mining Engineering Department, Rockscience -2D&3D Geotechnical software designed for civil and mining engineering	*	2018
7	Eskisehir Osmanagazi University Turkce Ogretimi, Uygulama ve Arastirma Merkezi, Turkce Yeterlilik Belgesi – Certifikatë për njohjen e Gjuhës Turke	Po	2015
4	Diplomë për njohjen e Gjuhës Angleze	Po	2008

*Trajnimi ka qenë i brendshëm për staf akademik (jo-Certifikues), ku në CV kandidati ka listuar programe që lidhen me hapjen, stabilitetin dhe projektimin nëntokësor.

Tabela X. Angazhimi në projekte

Nr	Lloji	Emri i projektit	Pozita në projekt	Kohëzgjatja
1	Ekspertizë profesionale	Vlerësim profesional i incidentit në guroren "ERTI" SH.P.K. Qirezë, Skenderaj.	Ekspert	7 ditë punë
2	Projekt i doktoratës	Stability assesment of Post Pillars in Cut and Filling Method at Trepca underground Mine (doctoral project no 201715AQ238), Eskisehir, Turkiye	PhD Cand.	2017

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, angazhimet profesionale në hulumtimet shkencore dhe projektet e tjera në të cilat ka marrë pjesë kandidati, programi prej të cilit është financuar projekti, çmimet dhe mirënjohjet, kualifikimet e ndryshme, patentat, inovacioni etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Kandidati Gzim Ibishi, është zgjedhur Kryesues i Konferencës Shkencore IMGC2024 e cila organizohet nga Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë, gjegjësisht Fakulteti i Gjeoshkencave. Po ashtu ka marrë pjesë në Komitetin Shkencor të Kongresit ICCET 2022 në Zonguldak/Turqi në vitin 2022.

Kandidati Gzim Ibishi, ka dëshmuar se ka përvojë menaxhuese në cilësi të Drejtorit të Institutit të Gjeoshkencave në Universitetin Isa Boletini në Mitrovicë, ku dëshmohet me vendim (nr. prot. 498 dt: 27.12.2022).

Kandidati Gzim Ibishi, ka qenë anëtar i SAIMM (South African Institute of Mining and Metallurgy) nga viti 2016.

4. Mobiliteti i kandidatit/es

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati/ja, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai/ajo ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore, qëndrime hulumtuese jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport)

Middle East Technical University, Turkey (2010-2011), Student exchange
Eskisehir Osmangazi University, Turkey (2014-2019), Doctoral studies
Zonguldak Bulent Ecevit University, Turkey (Maj-Tetor 2022), Post-doctoral studies

5. Vlerësimi i kandidatit/es në intervistë (në rastet e krijimit të marrëdhënies së punës për herë të parë)

(Në këtë pjesë të raportit, komisioni duhet të ofrojë të dhëna të sakta dhe të plota, sipas pikës 2 të nenit 167 të Statutit të UIBM dhe pikave 2,3,4 të nenit 11 Rregullores me nr. prot. 3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. prot. 1621 të dt. 26.07.2024).

Kandidati Gzim Ibishi, ka treguar cilësi të lartë në çështjet e ngritura në pyetjet gjatë intervistës, duke ofruar nivel të lartë të përshtatshmërisë lidhur me aftësitë pedagogjike dhe ato të mësimdhënies, specifikisht me lëndët e shpallura në konkurs. Gjatë përgjigjeve të tij, ai ka elaboruar gjerësisht mënyrat e avancuara të mësimdhënies, përdorimin e softwerëve për miniera gjatë mësimdhënies, interaktivitetin me student si dhe bashkëpunimin në nivel më të ngritur me universitetet ndërkombëtare.

6. Përfundimi dhe propozimi (titulli i cili propozohet)

(Anëtarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim për titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre për çdo kandidat/e. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa katër kapitujt paraprakë shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).

Komisioni vlerësues i formuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit të Gjeoshkencave të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", (Nr. Prot. 335) të datë 03.10.2024, duke u bazuar në Nenin 170 të Statutit të UIBM-së, në nenin 7, 10, 11 dhe 12 të Rregullores për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në Universitetin Isa Boletini në Mitrovicë, me Nr.Prot. 3013/1 të datës 21.12.2023, dhe Rregullores për plotësim dhe ndryshimin e Rregullores për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM me Nr.Prot. 1621/1 të datë 26.07.2024, si dhe në konkursin publik të shpallur të datës 09.09.2024 me Nr. Prot 1864, pas shqyrtimit, intervistimit dhe vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs, konstaton se:

- Kandidati Gzim Ibishi, i plotëson kushtet e parapara me Nenin 170 të Statutit të UIBM-së dhe nenit 7, 10, 11, dhe 12 të Rregulloreve me Nr. Prot. 3013/1 të datës 21.12.2023 dhe atë me Nr. Prot. 1621/1 të datës 26.07.2024, të zgjedhet *Profesor Asistent*, për herë të parë në lëndët: *Vlerësimi dhe hapja e minierave, Shfrytëzimi nëntokësor, Aplikimi i gjeomekanikës së avancuar, Modelimi numerik në gjeomekanikë, dhe Projektimi në shfrytëzim nëntokësor.*
- Kandidati Frashër Brahimaj, i plotëson kushtet e parapara me Nenin 170 të Statutit të UIBM-së. Mirëpo, bazuar në Nenin 10 (paragrafi 12) dhe Nenin 12 të Rregullores me Nr. Prot. 3013/1 të datës 21.12.2023 dhe atë me Nr. Prot. 1621/1 të datës 26.07.2024, refuzohet të zgjedhet *Profesor Asistent*, për herë të parë në lëndët: *Vlerësimi dhe hapja e minierave, Shfrytëzimi nëntokësor, Aplikimi i gjeomekanikës së avancuar, Modelimi numerik në gjeomekanikë, dhe Projektimi në shfrytëzim nëntokësor.*

Arsyetim:

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, Komisioni vlerësues vendosi të zgjedhë kandidatin Gzim Ibishi për pozitën në fjalë bazuar në elementet bazë:

- Ka përvojë të konsiderueshme dhe të suksesshme në arsimin e lartë, e në veçanti në grupin e lëndëve mësimore të shpallura me konkurs
- Fusha e doktoratës së tij dhe avancimi akademik i deritanishëm i takon fushës së ngushtë të studimeve dhe lëndëve për të cilat ai konkuron,
- Publikimet e deritanishme shkencore të tij, i takojnë fushës përkatëse.
- Është i certifikuar në bazë të trajnimeve të organizuar nga UIBM për mësimdhënie.
- Ka notën mesatare të studimeve BSc dhe MSc më të lartë në krahasim me kundër kandidatin dhe
- Posedon referencat përkatëse akademike për mësimdhënie dhe aftësi pedagogjike.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:
[të shënohet thirrja e saktë akademike]

1. Prof. Asoc. Dr. Muhamedin Hetemi



2. Prof. Asoc. Dr. Kemajl Zeqiri



3. Prof. Dr. Behxhet Shala



Datë: 07.10.2024